

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Datede / Izlazne: Date / Dana: 31 / 01 / 2025		
Nr. Orgv Org. jed. 01K	Nr. Prot. Br. Prot. 05	Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA E PROKURIMIT
 KANCELARIJA ZA JAVNE NABAVKE
 PROCUREMENT OFFICE

Tel. 038.200 46 039 /045/
 E-mail: prokurimi.ferizaj@rks-gov.net
 Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n.

Në bazë të neni 26 të Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. Autoriteti Kontraktues harton këtë:

ANEKS KONTRATË (PUNË SHITESË)

Punë shtesë – Asfaltimi i rrugëve të mbetura në fshatin Pleshinë.

E lidhur më 31.01.2025 ndërmjet,

Komunës së Ferizajt, Zyra e Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë të cilën e përfaqëson, znj. Arbërie Bekteshi – Udhëheqëse e Zyrës së Prokurimit dhe në anën tjetër,

Grupi i Operatorëve Ekonomik: "IPN GROUP" SH.P.K & "Quality Asphalt" SH.P.K, nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson në cilësinë e drejtorit z. Albion Vogliqi, (në vazhdim "punë kryesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një aneks kontratë për punët e shënuara më poshtë:

I.

Kontrata bazë 01K nr.155/2023 e datës 05.12.2023, **Asfaltimi i rrugëve të mbetura në fshatin Pleshinë**, gjatë kryerjes së punëve janë paraqitur punë shtesë sipas procesit të organit mbikëqyrës. Autoriteti Kontraktues (Komuna e Ferizajt) me njoftimin në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) ka lejuar lidhjen e aneks kontratës për këto punë.

II.

Vlera e kësaj aneks kontrate për punët shtesë do të jetë: **19,010.00 € (Nëntëmbëdhjetë mijë e dhjetë euro e zero cent)** e cila shumë është **9,54%** e vlerës së kontratës bazë. Vlera e kontratës bazë është: **199,107.49 € (Njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatë euro e dyzet e nëntë cent)** të gjitha sipas paramasës së ofruar nga organi mbikëqyrës për punët shtesë dhe çmimeve për njësi të respektuara nga oferta bazë me të cilën është lidhur kontrata bazë.

III.

Punë kryesi detyrohet që punët shtesë të paraqitura në këtë projekt të filloj implementimin e tyre nga data e nënshkrimit të kontratës dhe deri më 10.02.2025 t'i përfundoj punë shtesë, sipas paramasave të përcaktuara nga organi mbikëqyrës.

IV.

Autoriteti Kontraktues si organ mbikëqyrës për këtë aneks kontratë cakton z.Emin Misini – zyrtar në DSHPE, i cili ka qenë mbikëqyrës në kontratën bazë të këtij projekti.

V.

Autoriteti kontraktues merr për detyrim se pagesën e punëve të përshkruara në këtë kontratë do t'i bëjë punët në afat prej 11 ditësh nga data e marrjes së raportit mbi kryerjen e punëve nga mbikëqyrësi.

VI.

Kontraktuesit kanë arritur marrëveshjen se në rast kontesti për interpretimin e kësaj kontrate do të jetë kompetente Gjykata Themelore ne Ferizaj.

VII.

Kjo kontratë është hartuar ne 4 kopje identike, palët kontraktuese pasi që e lexojnë të njëjtën me nënshkrimet e veta e pranojnë për të veten pa vërejtje.

K O N T R A K T U E S I T:

Grupi i Operatorëve Ekonomik
"IPN GROUP" SH.P.K
"Quality Asphalt" SH.P.K

z.Albion Vogliqi

v.v.



Autoriteti Kontraktues
Zyra e Prokurimit

znj.Arberie Bekteshi

*Puna Shtesë
Paramasa*

Vërejtje: Në çmim për njësi të llogaritur të gjitha taksat e aplikuara në Republikën e Kosovës!

P.SH	Rrugica te ndryshme				
Nr.	POZICIONI	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Vlera(€)
1	PROJEKTI I RRUGËS				
1.1	INÇIZIMET DHE PUNET PARAPRAKE NE TEREN				
1.1.1	Mobilizimi dhe rregullimi i punishte për punë si dhe largimi i instalimeve ne punishte në rast se ka në ato hapësira.	m'	260.00	0.10	26.00 ✓
1.1.2	Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontrollë të trafikut gjatë kryerjes së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë punimeve në zgjerimet e rruges	m'	260.00	0.10	26.00 ✓
1.1.3	Shenimi i trasesë, si dhe percjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit	m'	260.00	4.00	1,040.00 ✓
				TOTALI:1.1	1,092.00 ✓
1.2	PASTRIMI I TERENIT				
1.2.1	Pastrimi i terenit, prerja, largimi i shkurreve dhe drunjeve me diametër deri 50 cm, ne njerën dy anë të rruges	m'	260.00	1.00	260.00 ✓
1.2.2	Ngritja e pusetave ekzistuese deri ne nivelin e rruges me te gjitha elementet	cope	10.00	150.00	1,500.00 ✓
				TOTALI:1.2	1,760.00 ✓
1.3	PUNËT TOKËSORE				
1.3.1	Gërmimi i dheut i kategorisë III-IV dhe humusin, duke përfshi edhe kyqjet ,me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi min 10km.	m³	182.00	1.50	273.00 ✓
1.3.2	Formesimi dhe ngjeshja e nenbazeve se trupit te rruges me ngjeshmeri 30 MN/m² ,përfshihen edhe kyqjet.	m²	910.00	2.00	1,820.00 ✓
1.3.3	Furnizimi dhe punimi i bankinave material jokoherent, planifikim dhe ngjeshja t=10cm	m'	520.00	0.50	260.00 ✓
1.3.4	Formesimi dhe punimi i kanaleve te hapura	m'	-	-	- ✓
				TOTALI:1.3	2,353.00 ✓
1.4	KONSTRUKSIONI I TRASËS SË RRUGËS				
1.4.1	Furnizimi dhe punimi i mbushjes dhe stabilizimi me material guror jokoherent të sjellur nga huaza në largësi 10km me bartje, shtrirje në shtresa dhe ngjeshje me CBR>15%, me trashësi t=40cm, Msh=60 MN/m² ,përfshihen edhe kyqjet.	m³	40.00	6.00	240.00 ✓
1.4.2	Furnizimi dhe punimi i tamponit (80MN/m²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=20cm ,përfshihen edhe kyqjet.	m³	182.00	10.00	1,820.00 ✓
1.4.3	Furnizimi dhe punimi i tamponit (100MN/m²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=10cm, ne kete shtrese eshte llogaritur edhe sasia per rregullimin e gjeometrise ne kthesa dhe ne drejtim,përfshihen edhe kyqjet.	m³	91.00	15.00	1,365.00 ✓
1.4.4	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e bituagregatit 0-16mm ,t=7cm	m²	780.00	11.00	8,580.00 ✓
1.4.5	Furnizimi dhe vendosja e kapakve prej gize me aftesi mbajttese 25 ton	copë	10.00	180.00	1,800.00 ✓
				TOTALI:1.4	13,805.00 ✓
				TOTALI(punë shtesë)	19,010.00 ✓



Kryesuesi: *[Signature]*